



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 830 Prot.

Tiranë, më 28/03 /2024

VENDIM

Nr. 14, datë 28.03.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR MBYLLJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË INXHINIERI MEKANIKE, PROFILI ENER GjITIKË,
NË DEPARTAMENTIN E ENER GjITIKËS, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MEKANIKE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të MASR Nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me Nr. 153/2 Prot., Nr. 03, datë 01.03.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.03.2024,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për mbylljen e programit të studimit, Master Profesional në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë, në Departamentin e Energjitikës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, i cili nuk ka patur regjistrime për më shumë se dy vite.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari